

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6629
E martë, 14 qershor 2022
çmimi 0.40

Presidentja dekreton shtatë prokurorë me mandat fillestar



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPOZITA KËRKON NGA QEVERIA TA HEQË AKCIZËN E DERIVATEVE TË NAFTËS DHE TVSH-në PËR PRODHIMET BAZË



Partitë opozitare, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), kanë kërkuar të hënën nga qeveria Kurti ta heqë akcizën e derivateve të naftës dhe TVSh-në për prodhimet bazë. LDK-ja të hënën ka dorëzuar kërkesë për debat parlamentar dhe për rezolutën lidhur me masat që duhet të ndërmerren për

t'i ndihmuar qytetarët të përballen me çmimet në prodhime esenciale. Akuzave të opozitës për ulje të akcizës për derivate dhe për uljen e TVSh-së u është përgjigjur ministri i Financave dhe Transfereve, Hekuran Murati, i cili ka thënë se thirrjet për ulje të akcizës së naftës janë thirrje për trashje të fitimit të tregtarëve

AKTUALE



HILL: SERBIA TË MENDOJË NËSE "POZICIONI NEUTRAL" ËSHTË I QËNDRUESHËM F. 2

PËR PESË MUAJ IDENTIFIKOHEN 611 RASTE ME KANCER NË KOSOVË F. 3

SOT KUVENDI MBAN SEANCË F. 3

MË 17 QERSHOR KONJUFCA VIZITON LIDERËT E UÇK-SË NË HAGË F. 7

EKONOMI



KOSOVA INKURAJOHET QË KLIMËN E INVESTIMEVE TA PËRAFROJË ME PRAKTIKAT MË TË MIRA TË BE-së F. 8

ALARMON SPSPK-ja: NUMRI I PUNËTORËVE PO PAKËSOHET NË KOSOVË F. 8

SPORT



KOSOVA ME SYNIME TË MËDHA NË KAMPIONATIN EVROPIAN F. 10

Politikanët e Kosovës, pelegrinazh në Gjykatën Speciale për mëditje, afirmim apo pendim?! F. 7

Reagim i KMDLNj-së



KRYETARI I OVLUÇK-së, DEPUTETËVE: MOS E MIRATONI LIGJIN DISKRIMINUES NDAJ KATEGORIVE TË LUFTËS

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Hill: Serbia të mendojë nëse 'pozicioni neutral' është i qëndrueshëm

BEOGRAD, 13 QERSHOR - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Serbi, Christopher Hill, më 13 qershor deklaroi se Serbia duhet të mendojë se ku qëndron e ardhmja e saj dhe nëse "ky pozicion neutral" i Beogradit zyrtar është i qëndrueshëm.

Ai tha se në këtë mënyrë Serbia duhet ta marrë vendimin e vet. Hill u tha gazetarëve në Beograd se ajo që ndodhi në Ukrainë "është sulm brutal ndaj atij vendi dhe vazhdimi i vrasjes së civilëve është diçka krejtësisht e papranueshme në këtë shekull".

Ai shtoi se një zhvillim i tillë nuk është parë që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore. "Të gjithë jemi të vetëdijshëm se bota ka ndryshuar që nga shkurti dhe se ne të gjithë duhet të mendojmë sërish se ku jemi,

cili është pozicioni ynë dhe ku duam të jemi në të ardhmen", tha ai.

I pyetur se cili duhet të jetë prioriteti (për Serbinë) në këtë moment - vendosja e sanksioneve kundër Rusisë apo normalizimi i marrëdhënieve me Kosovën, Hill u përgjigj se këto janë çështje për autoritetet serbe. "Unë mendoj se kjo është pyetja që duhet t'ua bëni përfaqësuesve të qeverisë suaj. Unë e përfaqësoj qeverinë amerikane këtu dhe nuk jam këtu për të dhënë këshilla, kështu që ju duhet të gjeni me autoritetet serbe përgjigjet për këto pyetje", tha Hill.

Serbia ka dënuar pushtimin rus të Ukrainës në Kombet e Bashkuara, ndërkaq në Komitetin e OKB-së për të Drejtat e Njeriut votoi për përjashtimin e Rusisë nga ky trup ndërkombëtar.



Megjithatë, zyrtarët serbë kanë përmendur vazhdimisht se Serbia nuk do të vendosë sanksione ndaj Rusisë për shkak të lidhjeve miqësore me atë vend, si dhe për shkak të

varësisë energjetike nga Rusia dhe qëndrimit të Kremlinit për të mos njohur pavarësinë e Kosovës.

Vendet e Bashkimit Evropian, si dhe ShBA-ja, i kanë kërkuar

vazhdimisht Beogradit zyrtar që ta harmonizojë politikën e tij të jashtme me atë të Perëndimit.

Serbia është vend kandidat për anëtarësim në BE.

Zelensky: Ukrainasit po luftojnë për secilin metër të Severodonjeckut

KIEV, 13 QERSHOR - Forcat ukrainase dhe ato ruse janë duke luftuar ashpër për ta fituar kontrollin e Severodonjeckut, qytet në lindje të Ukrainës.

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka thënë se mbrojtësit e këtij shteti janë duke luftuar për "secilin metër" të qytetit, ndonëse rusët kanë shkatërruar një urë kyçe, duke pamundësuar ikjen potenciale të civilëve nga zonat e luftës. "Qëllimi kyç i pushtuesve nuk ka ndryshuar. Ata janë duke rritur presionin në Severodonjeck. Atje ka luftime të ashpra për secilin metër", ka thënë Zelensky në adresimin e tij të dielën vonë, duke shtuar



se ushtria ruse është duke shtuar rezervat në Donbas.

Guvernatori i rajonit të Luhanskut, Serhiy Hayday, ka

thënë më 12 qershor se forcat ruse kanë shkatërruar urën e dytë që lidh Severodonjeckun me qytetin Lisiçansk.

Ministria britanike e Mbrojtjes ka thënë në përditësimin e saj të fundit më 13 qershor, se operacionet e kalimit të lumit "ka mundësi të jenë në mesin e faktorëve vendimtarë për luftën".

Inteligenca britanike ka thënë se Rusia është duke u përballur me vështirësi që ta demonstrojë "koordinim kompleks, i cili është i nevojshëm për të kryer kalime të suksesshme rreth lumit teksa luftimet vazhdojnë".

Pavarësisht prej rritjes së presionit, Zelensky ka thënë se forcat ukrainase janë duke i penguar trupat ushtarake ruse nga marrja e Donbasit. "Ju

kujtohet sesi në Rusi, në fillim të muajit maj, ata shpresonin ta merrnin kontrollin e rajonit lindor të Donbasit?" ka pyetur Zelensky. "Është dita e 108 e luftës. Jemi në qershor. Donbasi ende po mbahet".

Severodonjecku ka mbetur pikë kritike e luftimeve, të cilat, sipas Kievit, do ta përcaktojnë rezultatin e luftës së paprovokuar që ka nisur Rusia në Ukrainë më 24 shkurt. Presidenti rus, Vladimir Putin, e konsideron luftën "operacion special" për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Kievi dhe Perëndimi e konsiderojnë këtë arsyetim si të rremë për nisje të luftës.

Rritja e së majtës rrezikon shumicën e Macronit në parlament

PARIS, 13 QERSHOR - Aleanca e qendrës së presidentit francez, Emmanuel Macron, rrezikon të mos fitojë shumicën pas raundit të parë të zgjedhjeve parlamentare të së dielës.

Në këtë proces zgjedhor është vërejtur rritje për koalicionin e krahut të majtë.

Aleanca "Së bashku" e Macronit ka garuar me grupin NUPES të së majtës në raundin e parë të zgjedhjeve. Macroni ka fituar mandatin e dytë presidencial në prill të këtij viti dhe këto zgjedhje

parlamentare janë parë si testi i parë për të.

Aleanca e Macronit ka fituar 25.75 për qind të votës së përgjithshme në krahasim me NUPES që ka fituar 25.66 për qind të votave.

Duke marrë parasysh këto shifra, katër kompani të sondazheve kanë parashikuar që aleanca e Macronit mund të fitojë në raundin e dytë të zgjedhjeve të dielën e ardhshme, ndonëse rrezikon shumicën, por shihet si grupi më i madh. "Ne kemi një javë për t'u mobilizuar", ka thënë

kryeministrja franceze Elizabeth Borne para gazetarëve. "Një javë për të bindur, një javë për të siguruar një shumicë të fuqishme". Sipas saj, aleanca e Macronit është grupi i vetëm politik që mund ta sigurojë shumicën.

Nëse ky koalicion nuk fiton shumicën, pritet që Macroni të sfidohet nga partitë e krahut të djathtë teksa çon përpara projektligjet dhe agjendën e tij. Sipas Kushtetutës së Francës, presidenti ka kontroll ekskluziv në politikën e



jashtme dhe atë të mbrojtjes, parlament për ta miratuar mirëpo i duhet shumica në legjislacionin e brendshëm.

Për pesë muaj identifikohen 611 raste me kancer në Kosovë

PRISHTINË, 13 QERSHOR (ER) - Për pesë muaj në Kosovë janë identifikuar 611 raste me kancer të cilat po trajtohen në Klinikën e Onkologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Në saje të raportit të punës për periudhën janar-maj 2022 janë

regjistruar 176 raste me kancer të gjirit, 65 raste me kancer në mushkëri, 140 raste me kancer gastrointestinal, 143 raste me kancer urogenital dhe 87 raste me kancer në kokë-qafë.

Mjekët onkologë kanë realizuar 19 495 kontrolle mjekësore

gjatë kësaj kohe, gjersa janë aplikuar 12 640 terapi me citostatikë.

Në Klinikën e Onkologjisë, në pjesën e parë të këtij viti, pa llogaritur muajin qershor, deri tash janë bërë 528 CT dhe 174 ECHO.



Kryetari i OVLUÇK-së, deputetëve: Mos e miratoni ligjin diskriminues ndaj kategorive të luftës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Ushtruesi i detyrës së kryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Faton Klinaku, ka bërë me dije se të martën do të mbahet seanca e Kuvendit të Kosovës, dhe si pikë është përsëri miratimi i projektligjit për ndryshimin e ligjeve, me anë të të cilit ky pushtet dëshiron t'i heqë veteranët e luftës nga lidhja me pagën minimale.

Ai u ka bërë thirrje deputetëve të pozitës dhe të opozitës që mos ta miratojnë ligjin diskriminues ndaj kategorive të luftës. "Të nderuar veteranë, invalidë dhe familje të dëshmorëve, nesër do të mbahet seanca e Kuvendit të Kosovës, dhe si pikë është përsëri miratimi i projektligjit për ndryshimin e ligjeve, me anë të të cilit ky pushtet po do që t'i

heqë veteranët e luftës nga lidhja me pagën minimale. Nuk mund të organizojmë protestë për nesër, sepse është kohë e shkurtër. Ju duhet që të jeni në kontakt me degët tona në mënyrë që kur t'ju thërrasim të dilni sa më masivisht. Nëse ky pushtet e ndryshon ligjin, ne ju thërrasim për protestë, ku do të qëndrojmë aty deri në realizimin e të drejtave tona. Thirrje deputetëve të pozitës dhe opozitës, mos e miratoni ligjin diskriminues ndaj kategorive të luftës, sepse do t'i bartni pasojat edhe ju sikur qeveria", ka shkruar Klinaku në "Facebook".

Ai e ka quajtur dyfytirësh kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca. "Dyfytirësia e Glauk Konjufcës! Në njërin anë futet në rend dite projektligji kundër veteranëve, në anën tjetër shkon t'i vizitojë veteranët që gjenden në paraburgim në Hagë", ka shkruar kryetari i OVLUÇK-së.



Presidentja dekreton shtatë prokurorë me mandat fillestar



PRISHTINË, 13 QERSHOR (ER) - Me propozimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani Sadriu, ka dekreton të hënën shtatë prokurorë. Këta prokurorë janë dekreton me mandat fillestar për tri vjet dhe do të sistemohen në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, Pejë, Gjakovë dhe Ferizaj.

Në ceremoninë e betimit para presidentes së vendit, prokurorët e rinj janë betuar se "do t'i qëndrojnë besnik Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ligjeve në fuqi dhe do t'i respektojnë rregullat e etikës profesionale".

Ndërkaq, presidentja Osmani ka theksuar se shteti ligjor dhe i së drejtës është parakusht për

funksimin e shtetit dhe shoqërisë, duke u bërë thirrje prokurorëve të rinj që në punën e tyre të jenë të pakompromis ndaj krimit dhe korrupsionit.

Njëkohësisht, presidentja ka theksuar se integriteti dhe profesionalizmi i prokurorëve janë elemente thelbësore për një sistem të drejtësisë që garanton barazi për të gjithë dhe besim qytetar.

Sot Kuvendi mban seancë

PRISHTINË, 13 QERSHOR (ER) - Kryesia e Kuvendit të Kosovës të hënën ka mbajtur mbledhjen e radhës, të kryesuar nga kryetari Glauk Konjufca. Në këtë mbledhje, në të cilën ishin të pranishëm edhe kryetarët e grupeve parlamentare, u vendos që të martën, më 14 qershor, duke filluar nga ora 13:00, të

mbahet vazhdimi i punimeve të seancës plenare të datës 5, 11, 13 maj dhe 6 qershor 2022, si dhe vazhdimi i punimeve të seancës së datës 26 maj dhe 6 qershor 2022, me pikat e papërfunduara.

Po ashtu, kryesia vendosi që seanca e re plenare të mbahet më 16 qershor.

Më tutje, kryesia e procedoi

për në qeveri Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, kurse mocionin e dhjetë deputetëve nga GP i LDK-së për shkarkimin e Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE-së) e procedoi te Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti.





Opozita kërkon nga qeveria ta heqë akcizën e derivateve të naftës dhe TVSh-në për prodhimet bazë

Partitë opozitare, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), kanë kërkuar të hënën nga qeveria Kurti ta heqë akcizën e derivateve të naftës dhe TVSh-në për prodhimet bazë. LDK-ja të hënën ka dorëzuar kërkesën për debat parlamentar dhe rezolutën lidhur me masat që duhet të ndërmerren për t'i ndihmuar qytetarët të përballen me rritjen e çmimeve në prodhimet esenciale. Akuzave të opozitës për ulje të akcizës për derivate dhe uljen e TVSh-së u është përgjigjur ministri i Financave dhe Transfereve, Hekuran Murati, i cili ka thënë se thirrjet për ulje të akcizës së naftës janë thirrje për trashje të fitimit të tregtarëve

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka dorëzuar të hënën kërkesën për debat parlamentar dhe rezolutën lidhur me masat që duhet të ndërmerren për t'i ndihmuar qytetarët të përballen me rritjen e çmimeve në prodhimet esenciale. LDK-ja ka njoftuar se me kohë ka propozuar reduktimin e akcizës në derivate dhe reduktimin e TVSh-së në prodhime esenciale, derisa sot çmimi i naftës po shënon rekord të ri prej 1.90 eurove për litër; derisa inflacioni i gjithëmbarshtëm ka arritur në plot 13 për qind. "Ka mbi një vit që çmimet e produkteve dhe shërbimeve në Kosovë kanë pësuar një rritje enorme. Ky

inflacion, veçanërisht i theksuar te produktet esenciale si ushqimi, derivatet dhe energjia elektrike, ka krijuar dhe vazhdon të krijojë vështirësi financiare për buxhetin e secilës familje kosovare, për secilin qytetar në Kosovë. Shtoj kësaj dhe faktin që niveli i përgjithshëm i pagave nuk ka ndonjë rritje të theksuar gjatë kësaj periudhe dhe situata rezulton e papërbalueshme për qytetarët dhe familjet e vendit tonë. Andaj, duke u bazuar në situatën e krijuar, Lidhja Demokratike e Kosovës përmes grupit parlamentar sot ka dorëzuar kërkesën për debat parlamentar dhe rezolutën për masat që duhet të ndërmerren për t'i ndihmuar qytetarët të përballen me rritjen e çmimeve në produktet esenciale", është

thënë në njoftimin e LDK-së.

Ky subjekt politik ka theksuar se kërkon nga Kuvendi i Kosovës t'i votojë këto rekomandime: 1. Të reduktohet akciza dhe norma e TVSh-së për derivate për tre muaj, me mundësi vazhdimi të masës edhe për tre muaj të tjerë, varësisht nga zhvillimet në tregjet ndërkombëtare; 2. Të zgjerohet lista e produkteve të domosdoshme me normë të reduktuar të TVSh-së për tre muaj, me mundësi vazhdimi të masës edhe për tre muaj të tjerë, varësisht nga zhvillimet në tregjet ndërkombëtare.

Edhe deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e AAK-së, Pal Lekaj, ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës ta heqë akcizën për derivatet e naftës dhe uljen e TVSh-së për prodhimet bazë.

Lekaj ka thënë se kjo duhet të ndodhë para se të bëhet vonë për qytetarët e Kosovës. "Kah po shkon qeveri? Hiqeni akcizën e derivateve dhe TVSh-në për produktet bazë para se të bëhet vonë për qytetarët e Kosovës", ka shkruar Lekaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Ditë më parë edhe kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka kërkuar që qeveria Kurti ta heqë akcizën për naftë dhe ta lejojë funksionimin e tregut të lirë, sepse çmimet aktuale të derivateve janë të papërbalueshme për xhepin e qytetarëve të Kosovës.

Kreu i PDK-së, Memli Krasniqi, tha se kanë kaluar fiks tre muaj nga data 10 mars, që kur PDK i ka bërë thirrje qeverisë ta heqë akcizën për naftën dhe ta shqyrtojë mundësinë për ulje të TVSh-së për produktet esenciale. "Ka disa muaj, po veçanërisht ditët e fundit me shqetësim të madh jemi duke e përcjellë ngritjen e normës të çmimeve të naftës dhe i kemi përcjellë gjatë gjithë ditës sot edhe reagimet dhe qëndrimet e naftëtarëve të Kosovës, por edhe qëndrimet krejtësisht arrogante të qeverisë për ta vazhduar cenimin e tregut të lirë dhe imponimin e rregullave

që janë, për mendimin tonë, joparimore", tha kreu i PDK-së.

Krasniqi kritikoi qeverinë se po i rrit të hyrat nga çmimi i lartë i naftës dhe këtë po e shet si sukses në zhvillimin e taksave. "Sot përafërsisht nga 64 centë nga çmimi që ne paguajmë për çdo litër naftë, por edhe benzinë i shkon qeverisë. Pra, qeveria është duke i rritur të hyrat përmes ngritjes së çmimit dhe pastaj po na e shet neve si sukses në zhvillimin e taksave. Realisht, është duke e vështirësuar dhe përkeqësuar mirëqenien dhe jetën e qytetarëve", tha ai.

Akuzave të opozitës për ulje të akcizës për derivate dhe uljen e TVSh-së u është përgjigjur ministri i Financave dhe Transfereve, Hekuran Murati. Ai ka thënë se thirrjet për ulje të akcizës së naftës janë thirrje për trashje të fitimit të tregtarëve. "Që nga marrja e mandatit ne si qeveri nuk kemi ngritur as edhe një taksë të vetme, as TVSh-në, as akcizën e naftës. Me fjalë të tjera, nuk ka as edhe një veprim të vetëm të qeverisë që do të kishte ndikuar në rritjen e çmimit të naftës. Rritja e çmimit të naftës vjen si rezultat i rritjes së çmimit të furnizimit nga importi, që është jashtë kontrollit tonë, por edhe për shkak të rritjes

PDK-ja dhe AAK-ja kërkojnë sërish heqjen e Projektligjit për Paga nga diskutimi në Kuvend

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) kanë bërë sërish thirrje që Projektligji për Pagën Minimale të hiqet nga rendi i ditës në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës, e cila është caktuar për 14 qershor.

Pas mbledhjes së rregullt të Kryesisë së Kuvendit, shefat e grupeve parlamentare të PDK-së dhe të AAK-së, Abelard Tahiri dhe Besnik Tahiri, e kanë quajtur Projektligjin për Paga diskriminues. "Lënia jashtë e kategorisë më të ndjeshme në vendin tonë, pra veteranëve të Republikës së Kosovës, është një çështje të cilën, në asnjë rrethanë, ne si grupe parlamentar i opozitës nuk do ta përkrahim", ka thënë Abelard Tahiri.

Ngjashëm është shprehur edhe shefi i grupit parlamentar i AAK-së. "E shoh si ligj diskriminues, e shoh si ligj totalisht të pamatur dhe e shoh si ligj që e dëmton në esencë një kategori të rëndësishme, të nderuar të vendit tonë, veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", ka thënë Tahiri.

Rritja e pagës minimale nga 170 në 264 euro bruto (250 neto) është paraparë me disa ndryshime ligjore të sponsorizuara nga Qeveria e Kosovës.

Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) kanë protestuar më 6 qershor para Kuvendit të Kosovës për shkak të mospërfshirjes së pensioneve të tyre në rritjen e pagës minimale. Deri më 2017 pensioni i veteranëve nuk ka mundur të

jetë më pak se paga minimale në Kosovë, që është 170 euro, sa aktualisht marrin. Por, sipas zëdhënësit të Qeverisë së Kosovës, Përparim Kryeziut, nga viti 2017, kur është bërë një plotësim-ndryshim i Ligjit për Veteranët e Luftës, një ndërlidhje e tillë më nuk parashihet.

Ministri i Punës, Financave dhe Transfereve në Kosovë, Hekuran Murati, gjatë raportimit në Komisionin Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale më 7 qershor, ka theksuar se "nuk është se shteti jep pak për veteranin", por "veteranin i kanë hyrë në hise disa të tjerë që ndoshta mund të mos jenë veteranë". "Ky është problemi që kemi ngritur si qeveri. Edhe kryeministri (Kurti) ka thënë që duhet të bëhet një

pastrim i listave", ka thënë Murati.

Nga Instituti i Kosovës për Drejtësi dhe nga Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet, "Çohu", kanë vlerësuar se pa përfunduar procesi gjyqësor lidhur me rastin "Veteranët" pastrimi i listës së veteranëve nuk mund të bëhet. Gjykata e Apelit më 26 prill të vitit 2022 ka kthyer në rigjykim rastin e njohur si "Veteranët". Në akuzën e ngritur nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, e cila ishte konfirmuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë më 19 qershor të vitit 2019, u ngrit dyshimi se për 19 500 persona është dhënë statusi i veteranit në mënyrë të paligjshme.

Aktualisht, sipas të dhënave zyrtare nga Qeveria e Kosovës,

statusin e Veteranit Luftëtar e kanë 53 188 persona kurse, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, 37 006 janë përfitues nga skema për veteranët e luftës.

Kur më 2017 është shfuqizuar neni i Ligjit për Veteranët e Luftës, i cili parashihte që pensioni i veteranit mos të jetë më i ulët se paga minimale, i njëjti është plotësuar me nenin që parashihte kategorizimin e veteranëve - varësisht nga vitet e angazhuara në UÇK - gjë që deri më tani nuk ka ndodhur.

Vlera e pagës minimale në Kosovë nuk ka ndryshuar nga viti 2011.

Shuma e pagës minimale në Kosovë është më e ulëta në Evropë, sipas Agjencisë Evropiane të Statistikave, Eurostat.



së marzhës së fitimit nga tregtarët e naftës, sidomos tani kur pritet ardhja e mërgatës. Prandaj po punojmë për një vendim që cakton çmim tavan dhe marzhë maksimale të fitimit, sepse në situata të tilla të jashtëzakonshme është e domosdoshme që qeveria të ndërhyjë në treg për t'i stabilizuar çmimet, gjë që parashihet edhe me legjislacionin në fuqi", ka thënë ai.

Murati ka thënë se thirrjet e opozitës që qeveria ta ulë TVSh-në apo akcizën në naftë ose produkte të tjera nuk i shërbejnë interesit të qytetarëve. "Përkundrazi, një veprim i tillë vetëm sa do t'i trashte fitimet e tregtarëve në njërin anë dhe do t'i kufizonte mundësitë e shtetit që t'i mbështesë familjet në

nevojë në anën tjetër. Ulja e TVSh-së apo akcizës në situata inflacionare, jo domosdo reflektohet në zbritje të çmimit te konsumatori. Dëshminë më të mirë për këtë e kemi parë përgjatë tërë vitit të kaluar, kur me Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike të qeverisë Hoti, TVSh-ja për bizneset e gastronomisë ishte ulur nga 18 për qind në 8 për qind për tërë vitin 2021. Përkundër kësaj, për asnjë moment çmimet e kafesë dhe produkteve të tjera të gastronomisë nuk u zbritën, sepse e tërë ulja e TVSh-së u kthye në marzhë shtesë të fitimit për bizneset", ka deklaruar Murati, duke shtuar se nga ulja e TVSh-së, konsumatori s'kishte fituar asgjë, shteti kishte humbur tatime që

përndryshe do t'i mblidhte, dhe kësaj shteti kishte më pak buxhet për t'i ndihmuar të varfrit. "Pikërisht këtë efekt patëm paralajmëruar asokohe më 2020 sa ishim si opozitë në Kuvend dhe teksa po diskutohej për Ligjin për Rimëkëmbje. Ashtu edhe ndodhi. Situata dhe sjellje të ngjashme ka edhe tani në vendet ku është ulur akciza e naftës nga shteti. Zbritja për konsumatorin në rastin më të mirë ka zgjatur disa ditë, pastaj çmimet janë ringritur dhe janë kthyer pothuajse në nivelin para uljes së akcizës. Në Gjermani tani po diskutohet se si të aplikohet taksë speciale për fitimet e kompanive të naftës të cilat kanë shfrytëzuar uljen e akcizës nga shteti për ta trashur marzhën e

fitimit për vete, duke ringritur çmimet vetëm pak ditë pas zbritjes fillestare", është shprehur ministri Murati.

Ai i është referuar opozitës me emrin 'PLAN'. "Tani të kthehemi te opozita PLAN. Askush nuk mund të më bindë se ata nuk i dinë këto fakte që prezantova më lart. Së paku nga shkollat që kanë kryer për ekonomi, do të duhej t'i dinin. Mirëpo, çështja qëndron diku tjetër. Nuk është hera e parë që në emër të dhembshurisë për qytetarët, partitë e gardës së vjetër me para të buxhetit tentojnë t'u bëjnë favore bizneseve të caktuara. E kemi rastin e heqjes së taksës minerare për Ferronikelin dhe për gurthyesit ku buxheti ishte dëmtuar më shumë se 15

milione euro. E kemi pagesën e 60 milionë eurove me pretendimin se po mbështetin punëtorët për pandemi e, në fakt, më së shumti përfituan supermarketet, dhe kemi shumë vendime të tjera që kanë dëmtuar buxhetin, e kanë rrezikuar bankrotimin e shtetit, gjithnjë duke u thirrur në emër të qytetarëve. Ngjashëm edhe tani, në emër të qytetarëve, po kërkojnë që shteti të heqë dorë nga të hyrat e taksave, por qëllimi është të trashja e fitimit për tregtarët. Deri më tani çdo taksë që ne kemi mbledhur e kemi kthyer te qytetari. Kështu edhe do të vazhdojmë sepse, për dallim nga ata që ishin, kjo qeveri është në anën e qytetarëve", ka thënë Murati.

Kosova mes përballjes faktORIZUESE dhe zMBRAPSJES IZOLUESE (3)



Shkruan: Agron HOTI

Sa herë i kemi dalë përballë Serbisë kemi fituar, sa herë i kemi heshtur apo i kemi zbrapsur e kemi inkurajuar që edhe më shumë të na sulmojë. I kemi dalë përballë në luftë, në Rambujë, në Vjenë, në GjND, në Bruksel, në Nju-Jork, në Uashington dhe në pafund forume e iniciativa rajonale e ndërkombëtare dhe në të gjitha këto raste kemi fituar dhe njëkohësisht jemi faktorizuar. Asgjë s'do më shumë Serbia sesa zbrapsjen tonë dhe izolimin, zaten ky edhe është qëllimi i saj. Edhe pse në Proces të Berlinit dhe në Proces të Stabilizim Asociimit dhe në të gjitha iniciativat e shumta rajonale përfaqësohemi me fusnotë, është prezenca fizike e jona ajo që luan mendsh Serbinë dhe kjo është dëshmuar më së miri me reagimet e saj shpesh të pakontrolluara plot mllef. Pa nënshkrimin e Kosovës s'ka

Proces të Berlinit, Ballkan të Hapur e as Integrim të rajonit në BE. E Kosova, për ta nxjerrë Serbinë e Rusinë prej loje, duhet shkuar nëpër takime të çdo iniciative rajonale për t'iu bërë halë në sy Serbisë duke ja numëruar Vuçiqit të gjitha kushtet e Kosovës në tavolinë (siç po thotë Kosova që po ja numëron Serbisë në Bruksel), e jo duke u ikur takimeve rajonale, sepse mospjesëmarrja e Kosovës në Ballkan të Hapur çon ujë te Serbia e Rusia që synim strategjik e kanë izolimin rajonal dhe defaktorizimin e Kosovës.

Të jemi të sigurt, që në momentin e parë që Kosova do t'i thoshte po pjesëmarrjes nëpër takimet e Ballkanit të Hapur, kuptohet pa lëshuar pe asgjë para Serbisë sa i përket statusit të Kosovës, do të jetë Serbia e para ajo që do të mundohet ta braktisë e para "Ballkanin e hapur", ose nëse jo Serbia do të ishte Rusia ajo që do të mundohet që me çdo kusht ta tërhiqte Serbinë mbrapa. Gjithsesi, nuk duhet harruar se Kosova me Serbinë është këmbëkryq në CEFTA dhe në pafund iniciativa rajonale ku Ministra tanë shkojnë edhe në Beograd nëpër takime, apo ku drejtuesit tanë më të lartë shtetërorë takohen rregullisht

me ata serbë nëpër forume të ndryshme rajonale dhe evropiane.

Fundja, si e kundërshtuaka Kosova Ballkanin e Hapur kur importet e Serbisë në Kosovë në vitin 2021 kishin tejkaluar importet e Shqipërisë? Përderisa Kosova heziton të bashkëpunojë me Shqipërinë për Ballkanin e Hapur, në anën tjetër i lulëzon importi i mallrave serbe në Kosovë.

Cila është logjika thellimit të hendekut me Shqipëri kurse e rrëshqitjes ekonomikisht nën Serbi?

Prandaj, vetëm duke u përballur me Serbinë në dialog si e barabartë mes të barabartëve, në çdo forum, iniciativë e mekanizëm rajonal e ndërkombëtar, Kosova ia del të faktorizohet dhe del nga izolimi, në të kundërtën izolohet e defaktorizohet saktësisht siç projektton që sa kohë Rusia dhe Serbia.

Ndërkohë që SHBA e mbështet Ballkanin e Hapur dhe çdo iniciativë tjetër që integron rajonin së paku në aspektin ekonomik, për t'ia relaksuar më pas rrugën bashkëpunimit politik. E kjo loja mes patriotësh e tradhtarësh mes nesh është

po ashtu projektion rus e serb, sepse Kosova u duhet atyre (Serbisë e Rusisë) vetëm e përçarë dhe e thyer nga brenda, ashtu siç u duhen të gjithë shqiptarët e përçarë dhe të thyer gjithandej trojeve shqiptare.

Nuk qëndron as argumenti se Serbia në një Ballkan të Hapur pa kufi do të na gllabërojë ekonomikisht. Sepse ashtu si në Ballkan të Hapur edhe në çdo Zonë tjetër të Tregtisë së Lirë në glob gjithmonë ka një shtet më të fuqishëm se të tjerët por që ai shtet nuk i gllabëron anëtarët tjerë. Sigurisht që asnjë shqiptari nuk i pëlqen që Serbia të jetë shteti më i fortë ekonomikisht në Ballkan Perëndimor, por për fat të keq realiteti është i tillë.

Si duket kemi harruar që në të gjitha Zonat kryesore të Tregtisë së Lirë në glob gjithmonë ka një shtet më të fuqishëm brenda si p.sh.: BE ka Gjermaninë shtetin më të fuqishëm brenda saj; Zona e Tregtisë së Lirë USMCA (SHBA, Meksika, Kanada) ka SHBA-në shtetin më të fuqishëm, Zona e Tregtisë së Lirë MERCOSUR e Amerikës Jugore ka Brazilin shtetin më të fuqishëm, Zona e Tregtisë së Lirë ASEAN në Azi Juglindore ka Indonezinë shtetin më të fuqishëm e kështu me radhë.

Edhe në CEFTA ku Kosova ulet bashkë me Serbinë dhe rajonin, Serbia është shteti më i fortë dhe këtë nuk mund ta ndryshojmë edhe pse do të kishim dashur, ndaj kjo nuk duhet të jetë pengesë për bashkëpunim ekonomik rajonal.

Fqinjët nuk i zgjedh, i ke aty. Serbinë nuk e kemi zgjedhur, por e kemi në fqinjësi. Ekonomitë e vogla sikur ato të Ballkanit Perëndimor nëse nuk hapen e kanë shumë të vështirë të prosperojnë. Fundja po ta kishte zgjedhur BE izolimin, luftërat në Evropë s'do të përfundonin kurrë, ndaj edhe Evropa nuk do ta kishte këtë mirëqenie që e ka sot.

Sigurisht që kjo s'do të thotë që Kosova të lëshojë pe para Serbisë, përkundrazi t'i dalë përballë në çdo iniciativë dhe jo të zbrapsset prej saj, sepse sa herë i kemi dalë përballë Serbisë kemi fituar, sa herë kemi heshtur apo jemi zbrapsur prej saj e kemi inkurajuar edhe më shumë të na sulmojë.

Po t'i ishte frikësuar Kosova epërsisë ushtarake dhe ekonomike të Serbisë s'do të futej kurrë në luftë kundër saj, por pikërisht kur Kosova pavarësisht çmimit i doli përballë Serbisë edhe me luftë, humbi kjo e fundit dhe Kosova u bë shtet. (Fund)



48 raste aktive me Covid në Kosovë

Prishtinë, 13 qershor (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit, pas 221 testeve, katër qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19 dhe nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes.

Të hënën janë shëruar gjashtë qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 225 255.

Në total numri i rasteve aktive me Covid-19 është 48.

Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë

dhënë 1 829 850 doza të vaksinës. Deri më sot 823 417 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Po ashtu, deri më sot janë dhënë 102 974 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.



Reagim i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj)

Politikanët e Kosovës, pelegrinazh në Gjykatën Speciale për mëditje, afirmim apo pendim?!

Në Njësinë e Paraburgimit të Gjykatës Speciale në Hagë po mbahen si pengje tetë (8) qytetarë të Kosovës, të gjithë shqiptarë prej të cilëve dy, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj janë dënuar thuaja me dënime kapitale nga 4.6 vjet burgim në ndërkohë që Prokurori ka kërkuar nga 6 vjet burg për secilin prej tyre. Procesi ndaj Salih Mustafës është thuaja duke përfunduar dhe, së shpejti pritet një vendim i kësaj Gjykate në ndërkohë që Prokurori ende nuk është deklaruar për lartësinë e dënimit të kërkuar. Procesi ndaj Pjetër Shalës duket se nuk do të zgjasë shumë ndërsa mbetet problematike mbajtja në paraburgim e ish drejtuesve të lartë të UÇK-së dhe bartësve të posteve më të larta shtetërore në Kosovë, Hashim Thaçi, ish-president dhe ish-kryeministër i Kosovës sikur edhe ish-ministër për Punë të Jashtme dhe për një kohë të gjatë udhëheqës i PDK-së, Jakup Krasniqi për dy mandate kryetar i Kuvendit të Kosovës, ushtrues detyre i presidentit të Kosovës dhe ministër në Qeverinë e Kosovës, Kadri Veseli me dy mandate (jo të plota) si kryetar i Kuvendit të Kosovës dhe kryetar i PDK-së dhe Rexhep Selimi, disa mandate deputet i Kuvendit të Kosovës dhe në çastin e arrestimit shef i Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes. KMDLNj ia përkujton opinionit se të gjitha kërkesat për zëvendësim të masës së paraburgimit me një masë më të lehtë që kanë bërë avokatët e tyre janë refuzuar nga gjykatësi i procedurës paraprake sikur që nuk është pranuar asnjë garanci për administrim të masës së arrestit shtëpiak nga shtetet tjera ndonëse kjo masë parashihet me Rregulloren e Punës së Gjykatës Speciale. Shtete të fuqishme të cilat, në të njëjtën kohë janë edhe mbështetës financiar të punës së Gjykatës Speciale, ndonëse kanë ofruar garanci të mjaftueshme, në vazhdimësi janë refuzuar. Pastaj, pas kërkesës së gjykatësit të procedurës paraprake drejtuar Policisë së Kosovës për garancitë dhe pas përgjigjes së detajuar të Policisë së Kosovës se ka kapacitete të mjaftueshme profesionale për ta administruar masën e arrestit shtëpiak për të paraburgosurit, Gjykata Speciale në mënyrë fyese dhe tallëse ka shpërfillur garancitë e ofruara nga Policia e Kosovës. Me zgjerimin e aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit,



Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit po krijohen të gjitha kushtet që procesi gjyqësor të stërzgjetet që nënkupton se të privuarit nga liria do të mbahen në paraburgim deri në kohën kur të shpallet aktgjykimi, mbase i formës së prerë e që i tejkalon kufijtë e arsyeshem të një procesi gjyqësor në përpunje me të të drejtat e njeriut. Është evidente që të paraburgosurit e Gjykatës Speciale nuk kanë një adresë të saktë për t'i adresuar shqetësimet dhe shkeljet e të drejtave të njeriut. I ashtuquajtur i Avokat i Popullit Gjykatës Speciale është një institucion koti që nuk ka mandat t'i trajtojë këto shqetësime kurse, institucionet e Kosovës nuk kanë mandat të merren me këtë çështje sepse konsiderohet si ndërhyrje në drejtësi ndonëse as që kanë treguar se kanë ndonjë interesim të merren me këtë çështje përveçse t'i vizitojnë të paraburgosurit, çuditërisht, kohëve të fundit me një entuziazëm të shtuar. Gatishmëri joprincipiale për t'i vizituar kanë shfaqur edhe ata që, përjashtuar një apo dy rasteve, thuaja të gjithë të tjerët i kanë cilësuar si kriminelë, vrasës apo keqbërës që në mënyrë flagrante shkelë parimin e prezumimit të pafajësisë sipas të cilës: "asnjë i dënuar nuk konsiderohet fajtor deri sa aktgjykimi ta merr formën

përfundimtare dhe të prerë...".

Në rastin konkret ky parim është shkelur vrazhdë nga bartës më të lartë të institucioneve, ministra, deputetë dhe të tjerë. KMDLNj mëson se gjatë kësaj jave një delegacion i një komisioni parlamentar planifikon të shkojë në Hagë kurse më vonë edhe vet kryetari aktual i Kuvendit të Kosovës, mbase i shoqëruar me staf. KMDLNj ka takime thuaja të rregullta me familjarë të të paraburgosurve që mbahen pengje në Hagë dhe informohet për gjendjen shëndetësore të tyre dhe trajtimin që iu bëhet. Çdo vizitor që i viziton të paraburgosurit në Hagë paraprakisht e plotëson një formular dhe për vizitën e mundshme pëlqimin e japin të paraburgosurit sikur që ndodhi me vizitën e paralajmëruar të kryetarit të Kuvendit. Në formularë duhet të ceket se në çfarë cilësie realizohet vizita. KMDLNj, dy herë ka plotësuar kërkesën për vizitë ku e ka theksuar se vizita ka karakter ekskluzivisht monitorues duke përjashtuar çdo mundësi që vizita të bëhet në ndonjë cilësi tjetër. Për kërkesën e KMDLNj-së për t'i vizituar të paraburgosurit, ata nuk janë njoftuar fare siç ishte vepruar me vizitorët tjerë por, kërkesat janë refuzuar. Të paraburgosurit kanë

kërkuar që të vizitohen nga KMDLNj por se kjo është jashtë mundësive të KMDLNj-së. Familjarët e të paraburgosurve i kanë deklaruar KMDLNj-së se të paraburgosurit i kanë ditët e stërngarkuara me vizita apo paralajmërim të vizitave. Këto vizita kanë shumë kufizime dhe, si të tilla më shumë i pengojnë të paraburgosurit dhe, në të njëjtën kohë krijon një përshtypje mashtruese se kjo gjykatë është demokratike sepse i respekton standardet më të larta të drejtave të njeriut kurse, në jo pak raste pikërisht Prokurori i Specializuar në arsyetimin e kërkesës për vazhdim të paraburgimit thirret në deklaratat apo intervistat e disa zyrtarëve që kanë shprehur vullnet dhe gatishmëri (skajshmërisht të pasinqertë dhe imorale) që t'i vizitojnë të paraburgosurit. Madje, në jo pak raste, edhe prokurori sikur edhe gjykatësi i procedurës paraprake janë arsyetuar se të paraburgosurit ende kanë ndikim apo përpiqen të ushtrojnë ndikim në proceset politike në Kosovë kurse këto vizita vetëm sa mbështesin pallavrata e prokurorit dhe gjykatës.

KMDLNj këshillon të paraburgosurit që të reduktojnë maksimalisht këto vizita, sidomos

atë që janë dashakeqe e që bëhen për shkak të mëditjeve apo fotografive me ndonjë çinovnik të Gjykatës Speciale dhe të përqendrohen në vizita familjare apo me ekipet mbrojtëse. Nuk e keni asnjë rast të vetëm që pas ndonjë vizite të përfaqësuesve të institucioneve të Kosovës, të paraburgosurit të kenë përfituar në fushën e të drejtave të njeriut! Asnjë rast të vetëm!

Institucionet e Kosovës nuk janë të thirrura të merren me Gjykatën Speciale sepse ajo nuk i përgjigjet me asgjë "themeluesit" të kësaj gjykate por se i raporton BE-së. Pas një kohe, kur të rrëzohen argumentet politike për themelimin e kësaj gjykate, pa asnjë dyshim do të konstatohet se pikërisht kjo gjykatë është instrumenti më i fuqishëm i shkeljes së të drejtave të njeriut dhe dhunuesi më i madh i të drejtave të viktimave për qasje në drejtësi sepse parimin etnik dhe politik e vë mbi të drejtat e të gjitha viktimave, pa bërë dallime në baza etnike, moshore, fetare, statusit në shoqëri dhe të tjera. Po mbi këto baza, krejtësisht diskriminuese po bënë përpjekje të caktojë edhe shkallën e përgjegjësisë e që paraqet një racizëm juridik. Si për viktimat ashtu edhe për të akuzuarit!

Më 17 qershor Konjufca viziton liderët e UÇK-së në Hagë

PRISHTINË, 13 QERSHOR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, më 17 qershor do të udhëtojë drejt Hagës për t'i takuar liderët e UÇK-së të cilët janë duke u

mbajtur në paraburgim nga Gjykata Speciale. Lajmin e ka bërë me dije shefi i kabinetit të Konjufcës, Ilir Kërçeli. "Bashkë me kryeparlamentarin Konjufca

më 17 qershor udhëtojmë për t'i vizituar ish-krerët e UÇK-së në Hagë", ka shkruar Kërçeli në llogarinë e vet në "Facebook". Në qendrën e paraburgimit

në Hagë janë duke u mbajtur: Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi, Hysni Gucati, Nasim Haradinaj, Sali Mustafa dhe Pjetër Shala.



Kosova inkurajohet që klimën e investimeve ta përafrojë me praktikat më të mira të BE-së



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 13 QERSHOR - Zyrtarët nga Kosova dhe Bashkimi Evropian kanë mbajtur takim në Bruksel, në të cilin kanë diskutuar për zhvillimet gjatë vitit të kaluar në fushat e tregtisë, industrisë, doganave dhe tatimeve.

Diskutimi u zhvillua në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), e cila ka hyrë në fuqi në prill të vitit 2016. Gjatë takimit zyrtarët shkëmbyen mendime për fusha të ndryshme, duke përfshirë tregtinë, industrinë dhe politikën e NVM-ve, doganat, tatimet dhe lëvizjen e lirë të mallrave.

Në të gjitha fushat Bashkimi Evropian dhe Kosova ranë dakord për rëndësinë e zbatimit

të prioriteteve përkatëse të programit të reformës ekonomike, agjendës evropiane së reformave dhe rekomandimeve nga raporti i komisionit për Kosovën në 2021.

Bashkimi Evropian ka përhëndetur përparimin për kryerjen e reformave në disa fusha dhe i ka kërkuar Kosovës që ta rritë ritmin e zbatimit në të tjerat, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me agjendën evropiane të reformave.

Në fushën e tregtisë palët diskutuan për deficitin tregtar dhe zhvillimin e politikës tregtare.

Pas pikës së ulët të vitit 2020 në mes të pandemisë, tregtia ndërmjet Kosovës dhe BE-së u rikuperua mirë në vitin 2021 dhe BE-ja mbetet partnerja e parë tregtare e Kosovës.

Komisioni ka inkurajuar batimin dhe forcimin e vazhdueshëm të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) dhe ka kërkuar që protokollet shtesë për lehtësimin e tregtisë dhe tregtinë e shërbimeve të ratifikohen me shpejtësi.

Sa i përket klimës së investimeve, u inkurajua përafrimi i mëtejshëm me rregulloret dhe praktikat më të mira të BE-së. Në këtë drejtim përparimi në përafrimin me acquis për sa i përket homologimit të automjeteve u mirëprit gjithashtu. Miratimi i Ligjit për Tregtinë e Jashtme u mirëprit dhe Kosova u inkurajua që të zhvillojë një politikë për adresimin e deficitit tregtar.

Sa iu përket doganave dhe tatimeve, Kosova ka bërë përparim në ndryshimin e kodit

doganor dhe të akcizave për ta harmonizuar atë me legjislacionin e BE-së.

Komisioni Evropian, gjithashtu, ka përhëndetur hapjen e terminalit të parë doganor në pronësi publike dhe ka inkurajuar Kosovën që ta vazhdojë fazën e heqjes së tarifave të përdorimit për objektet doganore. Për më tepër, Komisioni Evropian ka theksuar rëndësinë e luftimit të mëtejshëm të ekonomisë informale dhe ka rekomanduar marrjen e hapave për ta hapur rrugën për një reformë gjithëpërfshirëse dhe të plotë të politikës tatimore, duke përfshirë vazhdimin e një digjitalizimi gradual të plotë të të gjitha shërbimeve tatimore.

Sa i përket politikës së industrisë dhe NVM-ve, Komisioni Evropian ka mirëpritur

themelimin e gjykatës komerciale e cila ka potencial për ta përmirësuar shumë mjedisin e biznesit në Kosovë.

Kosova u zotua të vazhdojë ta përmirësojë mjedisin e biznesit duke përfshirë rritjen e digjitalizimit dhe thjeshtimit të licencave dhe lejeve. Komisioni Evropian ka rikujtuar nevojën që Agjencia Kosovare e Investimeve dhe Përkrahjes së Ndërmarrjeve (KIESA) t'i mbështesë më mirë investimet dhe sektorin privat.

Në lidhje me lëvizjen e lirë të mallrave, diskutimi u fokusua në rritjen e kapaciteteve të institucioneve dhe përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit me acquis të BE-së me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës cilësore në fushat e standardizimit, akreditimit, vlerësimit të konformitetit, metrologjisë dhe mbikëqyrjes së tregut.

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) është korniza për BE-në dhe administratën e Kosovës për t'i diskutuar rregullisht çështjet teknike dhe politike në lidhje me reformat që kanë të bëjnë me BE-në. Organet e MSA-së përfshijnë Këshillin e Stabilizim-Asociimit, të ndihmuar nga Komiteti i Stabilizim Asociimit, si dhe nënkomitetet e MSA-së, të cilët mbulojnë një gamë të gjerë të acquis të BE-së. Takimet e organeve të MSA-së japin kontribut të drejtpërdrejtë në raportet vjetore të Komisionit Evropian.

Çdo takim i nënkomisionit monitoron dhe shoqëron zbatimin e reformave të Kosovës dhe identifikon se si BE-ja mund të ndihmojë në këtë proces.

Alarmon SPSPK-ja: Numri i punëtorëve po pakësohet në Kosovë

PRISHTINË, 13 QERSHOR (ER) - Sindikata e Pavarur e Sektorit Privat të Kosovës (SPSPK) ka njoftuar se është krizë e madhe për punëtorë të sektorit privat, në veçanti për ata me kualifikime.

Udhëheqësit e kësaj sindikate kanë realizuar javën e kaluar (të premten, të shtunën dhe të dielën) vizita në shumë kompani, lokale të gastronomisë, markete, ndërtimtari, kompani të sigurimeve fizike, kompani të derivateve të naftës, kompani që merren me mirëmbajtjen e objekteve dhe shumë profile të tjera.

Në kuadër kësaj vizite, SPSPK-ja ka njoftuar se u pa një mungesë e madhe e punëtorëve të secili sektor, u pa një shqetësim i madh të secili punëdhënës, pasi që këta punëtorë po ikin jashtë, mirëpo edhe po ka lëvizje të mëdha të punëtorëve pasi që tani pronarët e kompanive po shtyhen se cili do të ofrojë

kushte më të mira të punës. "Shumë kompani na thanë se po paguajnë punëtorë rezervë pasi që çdo moment numri i punëtorëve po pakësohet. Me qëllim të qetësisë sadopak të kësaj gjendje ne si sindikatë thërrasim aktorët përgjegjës të ndërtimtarëve, naftëtarëve, gastronomive, bujqësive, mini dhe supermarketave dhe të gjitha profileve të tjera që të bëjnë një program afatshkurtër dhe afatgjatë me qëllim që sado kudo këtë ikje ta ndalin duke u afruar punëtorëve kushte dhe paga më të mira. Kështu nuk shkon me programe dhe projekte të qeverisë. Me nga 250 euro pagë nuk po ndalen rinia dhe punëtorët", është thënë në reagimin e kësaj sindikate.

Sindikata e Pavarur e Sektorit Privat të Kosovës i ka çuar selam Qeverisë së Kosovës se as me 450 euro nuk po ndalet ikja e punëtorëve. "Këtë realitet ta faktojnë pronarët e kompanive që në njëfarë forme i morët në



qafe deri tash punëtorët, por edhe lakmitarët (pronarët e kompanive) tani fjalën e kanë punëtorët. Mjaft ua keni pi gjakun me pambuk, me paga

jonjerëzore, me mosrespektim të Ligjit të Punës dhe Ligjeve që kurrë nuk u interesoi as atyre me herët që ishin e as këtyre tani. Si me ligj si pa të, si me

Inspektorat të Punës si pa të, si me qeveri si pa qeveri, për punëtorët asnjëherë mirë", është theksuar në reagimin e SPSPK-së.

Arka e Besëlidhjes: Misteri i përjetshëm Biblik



Pyetja se ku ndodhet Arka e Besëlidhjes, i ka munduar për shekuj me radhë teologët dhe arkeologët. Është e vështirë të imagjinohet një objekt misterioz më imponues sesa Arka, një kuti që supozohet se është ndërtuar sipas udhëzimeve të vetë Zotit. Për izraelitët, ajo ishte objekti i fundit i shenjtë. Por, pasi shfaqet dukshëm në Bibël përgjatë Pesë Librave të Moisiut, Arka e Besëlidhjes zhduket nga tregimi biblik pas Librave të Kronikave, dhe fati i saj mbetet i paqartë.

Po çfarë është Arka e Besëlidhjes?

Në Librin e Eksodit, thuhet se Arka u ndërtua nga punëtorë shumë të aftë, që përdorën dru akacieje dhe ar. Udhëzimet për ndërtimin e Arkës, që iu dhanë Moisiut nga Zoti, ishin shumëspecifike: Thuaji njerëzve të tu të ndërtojnë një Arkë nga druri i akacies, 1.1 metra të gjatë, 0.7 metra të gjerë dhe po aq të lartë. Mbulojeni me ar të kulluar, si brenda ashtu edhe jashtë, dhe bëni rreth tij një kallëp prej ari” (Eksodi 25:10-11).

Ndërtimi i Arkës dhe Tabernakullit, faktore portative në të cilën do të vendosej, iu

besua një burri të quajtur Bezalel. Sipas Eksodit 31:3-5, Perëndia e mbushi Bezalelin me “Frymën e Perëndisë, me urtësi, me zgjuars, me njohuri dhe me të gjitha llojet e aftësive, për të bërë dizajne artistike me punime prej ari, argjendi dhe bronzi, për të prerë dhe vendosur gurë, punuar drurin dhe për t’u marrë me të gjitha llojet e zejeve”.

Pas përfundimit të saj, Arka u transportua duke përdorur dy shtylla, të bëra gjithashtu me drurin e akacies dhe ar, në shenjtëroren e brendshme të Tabernakullit, Shenjtin e Shenjtëve, ku u vendos nën një kapak prej ari. Në krye të pallatit të mëshirës, dy figura kerubinësh (Ëngjëjsh) të artë, u vendosën sipas udhëzimit të Perëndisë. Pllakat e gdhendura me Dhjetë Porositë u vendosën brenda arkës, nën krahët e shtrirë të kerubinëve. Po ashtu, arka u mbulua me një vello.

Një armë e shenjtë

Arka luan një rol të rëndësishëm në tregimet biblike të Eksodit nga Egjipti dhe pushtimit të Kananit. Në të dyja rastet, Arka e Besëlidhjes u përdor si mjet për të mposhtur armikun. Tek Eksodi, tregohet sesi Levitët e

marrin me vete Arkën në betejë, dhe prania e saj sjell arratinë e ushtrisë egjiptiane.

Tek Joshua, rrëfëhet se Arka u mbajt për 7 ditë pranë Xherikos, dhe në ditën e 7-të u shembën muret e këtij qyteti. Por Arka përmendet edhe në historinë e Samuelit, kur Zoti e përdor atë për t’ia zbuluar vullnetin e tij Elit. Ndërkohë në Librin e Mbretërve, Arka rrëmbehet nga filistinët, por në fund kthehet sërish në Izrael.

Çfarë ndodhi me Arkën e Besëlidhjes?

Arka përmendet shkarazi në Dhiatën e Vjetër pas 2 Kronikave 35:3, në të cilat mbreti Josiaurdhëron rikthimin e saj në Tempullin

“Vendoseni arkën e shenjtë në tempullin e ndërtuar nga Solomon, biri i Davidit, mbreti i Izraelit. Ajo nuk duhet mbajtur mbi supet e njerëzve”.

Ky tregim sugjeron se Arka u mbajt në tempullin e Solomonit deri kur babilonasit e pushtuan Jerusalemin në 586 Para Krishtit. Gjatë pushtimit, Tempulli u plaçkit dhe u shkatërrua, dhe qënga ai moment vendndodhja e Arkës ka qenë objekt spekulimesh.

Ku ndodhet sot Arka e Besëlidhjes?

Ka shumë teori rreth asaj që ndodhi me Arkën pas shkatërrimit të Tempullit të Solomonit. Disa besojnë se ajo u rrëmbye nga babilonasit dhe u çua në Babiloni. Të tjerë mendojnë se ajo ishte fshehur përpara se të vinin babilonasit, dhe se gjendet e fshehur diku në Jerusalemin.

Libri i Dytë i Makabenjve 2:4-10 thotë se profeti Jeremia u paralajmërua nga Zoti se pushtimi babilonas ishte i afërt, ndaj e fshehu Arkën në një shpellë. Ai këmbënguli se nuk do të zbulonte vendndodhjen e shpellës “deri në kohën që Zoti do t’i mblihte sërish njerëzit e tij dhe do t’i mëshironte”.

Një teori tjetër pretendon se Arka u çua në Etiopi nga Menelik, djali i Solomonit dhe mbretëresha e Shebës. Në fakt, Kisha Ortodokse Etiopiane, Tevahedo, pretendon se e ruan Arkën në qytetin Aksum, ku ajo mbahet nën mbikëqyrje të rreptë brenda një kisha.

Por kjo tezë është hedhur poshtë nga Eduard Ulendorf, ish-profesor i Studimeve Etiopiane në Universitetin e

Londrës, që pretendon se e ka ekzaminuar atë. “Ata kanë vërtet një kuti druri, por ajo është bosh. Ajo është ndërtuar maksimumi në Mesjetën e mesme deri në Mesjetën e Vonë”-thotë ai.

Ka shumë hamendje të tjera edhe më të diskutueshme. Kështu një teori pretendon se Kalorësit Tempullarë e çuan në Francë Arkën e Besëlidhjes. Një tjetër sugjeron që ajo përfundoi në Romë, ku u shkatërrua nga një zjarr që ra në Bazilikën e Shën Gjon Lateranit. Ndërkohë historiani britanik Tudor Parfit, mendon se arka është një artefakt të shenjtë, Ngoma Lungundu, që i përket popullit Lemba në Zimbabve. Parfit mendon se Arka u dërgua në Afrikë dhe se Ngoma Lungundu ose ‘Kutia e Bubullimave’ në gjuhën e Lemba, ishte e ndërtuar duke përdorur mbetjet e Arkës pas shpërthimit të saj 700 vjet më parë.

Ndërsa fati i Arkës së Besëlidhjes mund të mbetet gjithmonë një mister, e sigurt se do të mbetet edhe një simbol i fuqishëm fetar, dhe si një magnet i papërmbajtshëm për spekulime dhe teorizime për shumë vite në vijim. / HistoryHit – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enverti

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Kosova me synime të mëdha në Kampionatin Evropian

“Synimet janë që të punojmë, përgatitemi dhe paraqitemi sa më mirë. Çdo trajner kërkon që të jetë sa më i suksesshëm me kombëtare, por për këto synime do t'i flasim pas përfundimit të kampionatit”, ka thënë Fidan Shatri



PRISHTINË, 13 QERSHOR - Përfaqësuesja e femrave A tash e disa ditë ka filluar stërvitjet për t'u përgatitur për ndeshjet në kuadër të FIBA Kampionatit Evropian të Shteteve të Vogla, që do të zhvillohet në Qipro. Rreth atmosferës në ekip në ditët e para të stërvitjeve ka folur përzgjedhësi Fidan Shatri. “Çdo fillim është motivues, sidomos kur bëhet fjalë për Përfaqësuesen e Kosovës. Entuziazmi është maksimal si nga vajzat e Përfaqësueses, ashtu edhe për stafin. Të gjithë jemi të vetëdijshëm që po i mbrojmë ngjyrat e shtetit dhe kur bëhet fjalë për mbrojtjen e ngjyrave të shtetit mundohemi që ta japim maksimumin”, ka thënë Shatri, i cili ka folur edhe për pritshmëritë rreth këtyre ndeshjeve. “Tash është viti i dytë dhe është thyer akulli për pjesëmarrje në gara ndërkombëtare. Besoj se këto ditë që i kemi në dispozicion deri në udhëtimin në Qipro do

të mundohemi që të përgatitemi sa më mirë për pjesëmarrje”, ka shtuar ai. Vashat dardane zhvillojnë katër ndeshje për gjashtë ditë dhe, sipas Fidan Shatrit, ky ritëm i ndeshjeve mund të shkaktojë vështirësi. Këtë vit në listën e gjerë të Përfaqësueses janë ftuar edhe disa lojtare të reja që jetojnë dhe veprojnë jashtë vendit. “Lista është baza e vitit të kaluar, pasi që edhe vitin e kaluar jemi munduar që ta kombinojmë listën me lojtare të vjetra të cilat ndër vite kanë kontribuar në basketbollin e femrave dhe lojtareve të reja. Po mendoj që kjo ecje nga viti i kaluar dhe ky vit të jetë një themel i një baze të Përfaqësueses që të jetë në kontinuitet edhe viteve të ardhshme”, ka deklaruar Shatri. “Synimet janë që të punojmë, përgatitemi dhe paraqitemi sa më mirë. Çdo trajner kërkon që të jetë sa më i suksesshëm me kombëtare,

por për këto synime do t'i flasim pas përfundimit të kampionatit”, ka thënë Shatri. Në fund ka edhe një mesazh për vashat dardane. “Mesazhi për vajzat të cilat janë të ftuara është që ta japin maksimumin, pasi që duhet të krenohen që përfaqësojnë ngjyrat dhe flamurin e shtetit duke u paraqitur sa më mirë në këtë Kampionat Evropian, ndërkaq për tifozët dardanët, shpresojmë ta kemi përkrahjen e njëjtë si vitin e kaluar edhe këtë vit”. Vashat dardane në vitin e kaluar janë stolisur me medaljen e bronzit, në pjesëmarrjen e tyre të parë në gara zyrtare të FIBA-së. Ndeshjen e parë Kosova e zhvillon më 28 qershor me Maltën, pastaj më 29 qershor ballafaqohet me Andorrën. Më 30 qershor Kosova do ta zhvillojë ndeshjen e parafundit me Qipron, kurse ndeshjen e fundit e zhvillon më 2 korrik ndaj Norvegjisë.

SHKURT

Galatasaray insiston për Muriqin

Vedat Muriqi e mbylli huazimin në Mallorca dhe është rikthyer në Lazio, e cila e mban kartonin e tij. Por, 28-vjeçari do të largohet edhe nga kryeqyteti italian, pasi aty nuk la mbresa të mira duke i shënuar vetëm dy gola në një vit e gjysmë eksperiencë në “Olimpico”. Mediet turke raportojnë se Galatasaray e ka nisur një ofensivë për ta transferuar në Stamboll sulmuesin dardan. Presidenti i porsazgjedhur, Dursun Ozbek dëshiron t'ua bëjë dhuratë tifozëve kartonin e prizrenasit, njofton mediumi turk “Aspor”. Gjithashtu, edhe ish-klubi i tij, Fenerbahçe po mundohet ta rikthejë Muriqin në kryeqytetin turk. Lazio i kërkon 11 milionë euro për kartonin e lojtarit.

Hasanaj përforcon Ferizajin

Skuadra e Ferizajt që është inkuadruar në BKT Superligën e Kosovës në futboll e ka realizuar edhe një transferim. Mbrojtësi Donat Hasanaj është përforcimi më i ri i skuadrës së Ferizajt, kurse në edicionin e kaluar ishte pjesë e Dukagjinit nga Klina. “Klubi ynë ka arritur marrëveshje me mbrojtësin e ri, Donat Hasanaj. Hasanaj ishte pjesë e KF Dukagjinit nga Klina në sezonin vjeshtor, ku pati paraqitje mjaft të mira, ndërsa më parë ishte pjesë e FC Prishtina, KF Flamurtari dhe KF Drita. Klubi ynë i uron mirëseardhje Donatit, duke i uruar shëndet e shumë suksese në klubin tonë”, thuhet në njoftimin e Ferizajt. Skuadra që drejtohet nga Arbnor Morina është përforcuar në këtë afat kalimtar edhe me Edon Sadriu, Betim Haxhimusa, Leutrim Rexhepi, Bujar Shabani dhe Astrit Fazliu.

Pesë kundërshtarët e mundshëm të Ballkanit në Ligën e Kampionëve

Shtëpia më e madhe e futbollit në Evropë, UEFA, ka përcaktuar pesë kundërshtarët e mundshëm të Ballkanit në raundin e parë kualifikues në Ligën e Kampionëve. Kampionët e Kosovës, Ballkani, mund të përballet me gjigantin suedez, Malmo, në raundin e parë. Krahas Malmos, Ballkani mund të përballet edhe me Bodo/Glimtin e Norvegjisë, HJK Helsinkin e Finlandës, The New Saints e Uellsit dhe Zhalgiris e Lituanisë. Ndeshjet e para luhen më 5/6 korrik, ndërsa të kthimit më 12/13 korrik.

Krasniqi dhe Bach bisedojnë për thellimin e bashkëpunimit mes KOK-ut dhe IOC-së

Prishtinë, 13 qershor - Presidenti i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, Thomas Bach, ka marrë pjesë në inaugurimin e zyrave të reja të KOKSh-it, si dhe mori pjesë në ceremoninë e mbylljes së Ditës dhe Javës Olimpikë 2022 në Shqipëri. Të pranishëm ishin edhe drejtuesit e KOK-ut, presidenti Ismet Krasniqi dhe sekretari i përgjithshëm, Besim Aliti, të cilët përgëzuan KOKSh-in për zyrat e reja dhe organizimin e bërë me rastin e vizitës së presidentit Bach. “Një natë më parë u mbajt edhe darka e përbashkët, ku presidenti Krasniqi pati mundësinë të bashkëbisedojë me presidentin Bach për thellimin e bashkëpunimit mes KOK-ut dhe IOC-së, si dhe çështje të ndryshme të bashkëpunimit. Presidenti Krasniqi dhe sekretari i përgjithshëm, Aliti, bashkëbiseduan edhe James Macleod, drejtor i Solidaritetit Olimpik të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, me të cilin diskutuan për projekte të ndryshme”, thuhet në njoftimin e KOK-ut.

Lot dhe emocione, Marcelo largohet nga Reali

MADRID, 13 QERSHOR - Pas 16 vjetësh me fanellën e Real Madridit dhe 25 titujve të fituar (lojtari që ka fituar më shumti me Realin), Marcelo i ka dhënë lamtumirë klubit spanjoll. Gjatë fjalës

përsëritet në konferencën e shtypit, futbollisti brazilian nuk ia doli t'i mbante lotët, ndërsa falënderoi trajnerët dhe stafin e "Los Blancos", po ashtu edhe familjen e tij.

"Largohem që këtu me kokën lart, e di se familja është krenare për mua. Jam me fat dhe gjithçka kam arritur në jetë e kam arritur me punë. Kam pasur fat me njerëzit të cilët kanë

qëndruar përkrah meje, por kjo nuk është një lamtumirë e mirëfilltë pasi më duket sikur kurrë nuk do të iki nga Real Madridi. Nëse nuk më lejoni të hyj në ambientet e klubit, atëherë do të kemi



probleme", u shpreh me shaka 34-vjeçari.

Haalandi flet për herë të parë si lojtar i Cityt: Ditë krenarie për mua dhe familjen

MANCHESTER, 13 QERSHOR - 21-vjeçari do t'i bashkohet klubit më 1 korrik, pasi ka nënshkruar një marrëveshje pesëvjeçare në "Etihad Stadium" deri në verën e vitit 2027. Djali i ish-lojtarit të Cityt, Alfie, i cili nënshkroi pothuajse 22 vjet më parë me "qytetarët", Haaland junior konsiderohet gjerësisht si një nga sulmuesit më të mirë të Evropës dhe vjen në klub me një reputacion të jashtëzakonshëm golashënuesi, pas periudhave mbresëlënëse te Molde FK, Red Bull Salzburg dhe Borussia Dortmund. Haalandi shënoi 86 gola në 89 ndeshje në dy sezone e gjysmë me BVB, duke fituar Kupën e Gjermanisë dhe çmimin "Lojtari i Sezonit" në Bundesligë, në sezonin 2020-2021. "Kjo është një ditë krenarie për mua dhe familjen time. Gjithmonë e kam parë City dhe më ka pëlqyer sezonet e fundit. Nuk mund të mos e admironi stilin e tij të lojës, është



emocionues. Manchester City krijon shumë raste, çka është perfekte për një lojtar si unë. Ka kaq shumë lojtarë të klasës botërore në këtë skuadër, ndërsa Pep është një nga trajnerët më të mëdhenj të të gjitha kohëve, kështu që besoj se jam në vendin e duhur për t'i

pëmbushur ambicimet e mia. Dua të shënoj gola, të fitoj trofe dhe të përmirësohem si futbollist. Kam besim se mund t'i bëj këto këtu. Ky është një klub i mrekullueshëm për mua dhe mezi pres të filloj përgatitjet parasezonale", ka thënë Haaland.

Mançini: Ndaj Gjermanisë pres një Itali spektakolare

ROMË, 13 QERSHOR - Italia e Roberto Mançinit mori një barazim në ndeshjen e tretë të Ligës A të grupit 3 të Ligës së Kombeve kundër Anglisë. "Azzurët" mbajnë kreun e grupit. Për mikrofonat e "Rai"-t, trajneri i kampionëve të Evropës komentoi për ndeshjen e djemve të tij. "Ne kishim ndoshta shumë mundësi të mira se ata, por bëmë pak. Ata bënë një ndeshje të mirë. Nuk ishte e lehtë". Në fillim Gjermania, më pas Hungaria dhe në fund Anglia. Italia vazhdon të gjejë konfirmim përmes gjuhës së përbashkët të lojës, por trajneri sheh hapësirë të madhe për përmirësim. "Duhet të përmirësohemi shumë sidomos kur sulmojmë, duhet të shënojmë gola. Në pjesën e parë patëm tri raste që nuk duhej t'i humbnim. Ndonjëherë kemi bërë gabime kur dënim, ishim pak të përafërt, por është pjesë e rrugës së rritjes së djemve. Ne nuk mendonim se po bënim aq mirë sa kemi bërë. Kjo ndeshje nuk ishte e



lehtë. Duhet të punojmë për të provuar të shënojmë. Është e qartë nëse Fratesi do të shënonte pas pesë minutash, është një lojë krejtësisht tjetër. Por është e rëndësishme që ai të jetë aty, herën tjetër do ta bëjë", ka deklaruar Mançini, i cili ka dhënë edhe një koment lidhur me rastet e shumta që Italia po i shpërdoron: "Kemi

problem në shënimin, sidomos në gjashtë muajt e fundit. Kemi ngadalësuar dhe kjo nuk është mirë. Duhet të përmirësojmë shumë gjëra, rruga do të jetë ende e gjatë dhe plot gracka. Ndeshja e radhës do të jetë kundër gjermanëve. Pres të njëjtin impenjim. Do të ketë pak ndryshime. Do të jetë një ndeshje spektakolare".

SHKURT

Pas Romës, Xhakën e dëshiron edhe Leverkuseni

Mesfushori shqiptar i Arsenalit, Granit Xhaka, ka kontratë me klubin anglez deri në verën e vitit 2024, por vështirë se do të qëndrojë aty gjatë në Londër. Emri i tij është lidhur sërish me Romën, me Jose Mourinhon që vjet insistoi gjatë për shërbimet e 29-vjeçarit, ndërkohë që në skenë ka dalë edhe një klub gjerman. Bayer Leverkuseni po tenton ta rikthejë Xhakën në Bundesligë, aty ku luajti me M'Gladbach në vitet 2012-2016, sipas raportimeve të gazetarit të njohur Ekrem Konur. "Aspirinat", që do të luajnë në grupet e Ligës së Kampionëve sezonin e ri, po përgatitin një ofertë për ta marrë lojtarin e kombëtares zvicerane në huazim me të drejtë blerje për një shumë që duhet përcaktuar.

Juriqi e dëshiron Kumbullën te Torino

E ardhmja e Marash Kumbullës vazhdon të jetë e paqartë. "Corriere dello Sport" raporton se ish-trajneri i Kumbullës në skuadrën e Veronës, Ivan Juriqi, ka shprehur interesim që ta ketë Kumbullën në skuadrën e Torinos. E para duhet gjetur një akord me klubin verdhekuq, një formulë të përshtatshme, pasi Torino nuk mund të shpenzojë 20-25 milionë euro. As për Kumbullën nuk është e lehtë. Kalimi te Torino do të ishte një hap pas në karrierë, por për sa kohë Juriqi është futur personalisht në këtë negociatë mbetet një opsion që mediet italiane e marrin në konsideratë.

Enrique, pas fitores kundër Çekisë: Nuk e lëshojmë vendin e parë

Te Spanja e kanë kthyer në festë fitoren kundër Çekisë. Edhe dy ndeshje përfundon Liga e Kombeve, kurse Spanja komandon me një pikë më shumë se Portugalia. Trajneri Luis Enrique ka thënë se janë të lumtur për fitoren e arritur dhe ka premtuar se Spanja nuk do ta lëshojë vendin e parë në grup. "Jemi të lumtur, pasi e kemi mbyllur pjesën e parë të këtij edicioni në krye. Ambienti në Malaga ka qenë i shkëlqyer, ishte një tërmet. Të them të drejtën Çekia më ka pëlqyer shumë, sepse ka luajtur me intensitet, por ne ia kemi dalë. Nuk është aspak e lehtë të luash katër ndeshje në këtë fazë të sezonit. Jemi shumë të kënaqur sepse nuk kemi pasur as probleme me dëmtimet. Tani nuk e lëshojmë më kreun", ka thënë Enrique.

Hamiltoni: Gara më e vështirë e jetës time

Gara e Çmimit të Madh të Azerbajxhanit zhvilluar ditën e diel në pistën e Bakus ka qenë një makth për pilotin britanik Lewis Hamilton. Ai e nisi garën nga vendi i tetë dhe në fund e mbylli atë në vendin e katërt. Gjithsesi, ai ka vuajtur shumë në pistë problemet me "porpoising" (lëkundjet) që kishte njëvendëshja e tij. Makina tundej jashtëzakonisht shumë e, po ashtu, edhe koka e shtatë herë kampionit të botës në Formula 1, sa herë që Mercedesi kalonte në pjesën e drejtë, me një shpejtësi që i kalonte 300km/orë. Kjo ka sjellë mjaft probleme fizike te piloti britanik, që ka vuajtur, po ashtu, si shoku i tij i skuadrës George Russell (i tretë). "Kjo ka qenë gara më e vështirë e jetës time nga ana fizike, për dhimbjet e tmerrshme që kam provuar. Gjithsesi, rezultati është pozitiv, pasi u renditëm në vendet 3-4. Kur ta zgjidhim këtë problem, do të duelojmë për fitoren", ka thënë Hamiltoni. Ai mezi ka dalë nga makina e tij pas garës, ku është ndihmuar nga një inxhinier i Mercedesit.

De Ligt, synim kryesor i Chelseat

Chelsea pritet të ketë ndryshime të mëdha në edicionin e ardhshëm, sidomos në repartin e mbrojtjes. Gjiganti anglez ka mbetur pa mbrojtës të shquar si Antonio Rudiger dhe

Andreas Christensen të cilët janë larguar si futbollistë të lirë nga "Stamford Bridges", por duke parë zbrazëtinë që ka lënë dyshja e larguar, Chelsea po tenton të përforcohet gjatë afatit

kalimtar veror në këtë repart. Dëshira kryesore e trajnerit Thomas Tuchel për repartin defensiv është holandezi Matthijs de Ligt. Qendërmbrojtësi i Juventusit

vlen rreth 80 milionë euro, para që Chelsea është gati t'i shpenzojë vetëm e vetëm ta ketë në radhët e veta yllin holandez. Vetë lojtari thuhet se ka pranuar një transferim në

Angli dhe dy klubet janë në bisedime për të gjetur marrëveshje. Përveç De Ligt, Chelsea synon të përforcohet në mbrojtje edhe me Jules Kounde nga Sevilla.



KOMPANIA RAJONALE E MBETURINAVE
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UPLAŃANJA OTPLAĐA
K.R.M. "ÇABRATI"

Tel: +383(0)390/221 588
+383(0)46 19 55 55
www.cabrati.com
e-mail: info@cabrati.com
Gjakovë - Gjakovë

KOMPANIA RAJONALE E MBETURINAVE "ÇABRATI" SH.A. GJAKOVË, duke u bazuar nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr. 03L/212) dhe gjendjes momentale dhe nevojave të kompanisë për plotësim të vendeve të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, dhe Vendimit Nr. 97/2022 me Nr. Protokolli 1090 i datës 13.06.2022 të Kryeshefit Ekzekutiv, u vendos që me datë 14.06.2022 të Ri shpallet :

Konkurs publik

Për këtë pozitë:

I. SHOFER ME KATEGORI "B" me kohë të caktuar, me mundësi vazhdimi, por që 6/ gjashtë/ muajt e parë do të jetë në punë provuese.

Numri : 1/një/

I përgjigjet: Koordinatorit të Autoparkut në Operativës.

Vendi: Gjakovë.

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Kushtet e përgjithshme:

1. Të posedojnë nivelin e shkollimit: Shkollë e Mesme,
2. Të ketë më së paku 1 (një) vit përvojë të punës.

Kushtet e veçanta:

1. Të posedoj patentë shofer me kategori "B",
2. Të mos jetë i dënuar apo nën hetime,
3. Preferohet të ketë njohuri të punës dhe ngasjes/manipulimit/ me ekskavator.

Detyrat e punëve : për këtë pozitë mund t'i gjeni në Web faqen e kompanisë: cabrati.com

Paga : Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

Dokumentet e kërkuara:

Kërkesa, CV-ja, Diploma , Referenca e përvojës 1 (një) vit në punët relevante, Patentë Shoferi me kategori "B", Vërtetimin e Gjykatës që nuk është i dënuar (më i ri se gjashtë muaj), Dëshmia për njohurit e punës dhe ngasje-manipulim me ekskavator, dhe Letër Njoftimi.

Afati i paraqitjes së kërkesave për këtë pozitë është 8 /tetë/ ditë nga dita e publikimit dhe atë nga data 14.06.2022 deri me datë 21.06.2022 në ora 16:00.

Kërkesën me dokumentacionet e kërkuara, kandidatet duhet t'i dorëzojnë në drejtorin e KRM."Çabrati" SH.A. në Gjakovë, Rr."Mazllom Lakuci" pn. (tek zyra e Menaxherit të Burimeve Njerëzore). Dokumentet pa afat dhe të pakompletuara nuk do të merren për bazë. Pas kalimit të afatit të konkursit, kandidatet i nënshtrohen procedurës së testit provues dhe intervistës me gojë.



KOMPANIA RAJONALE E MBETURINAVE
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UPLAŃANJA OTPLAĐA
K.R.M. "ÇABRATI"

Tel: +383(0)390/221 588
+383(0)46 19 55 55
www.cabrati.com
e-mail: info@cabrati.com
Gjakovë - Gjakovë

KOMPANIA RAJONALE E MBETURINAVE "ÇABRATI" SH.A. GJAKOVË, duke u bazuar nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr. 03L/212) dhe gjendjes momentale dhe nevojave të kompanisë për plotësim të vendeve të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, dhe Vendimit Nr. 96/2022 dhe Nr. Protokolli 1087 i datës 13.06.2022, Kryeshefit Ekzekutiv vendosi që me datë 14.06.2022 të Ri shpallë :

Konkurs publik

Për këtë pozitë

1 /një/ INKASANTË me kohë të caktuar, me mundësi vazhdimi, por që 6/ gjashtë/ muajt e parë do të jetë në punë provuese.

Kushtet:

1. Të posedojnë nivelin e shkollimit: Shkollë e Mesme,
2. Të ketë më së paku 1 (një) vit përvojë të punës relevante,

Kushtet e veçanta:

1. Të ketë njohuri profesionale ose të ngjashme,
2. Të mos jetë i dënuar apo nën hetime,
3. Të ketë aftësi të mira psikofizike për punë me ngarkesa dhe përballje me kushtet në terren që kërkon vendi i punës,
4. Preferohet posedimi i patentë shoferit me "B" kategori më së paku.

Dokumentet e kërkuara:

Kërkesa, CV-ja, Diploma , Referenca e përvojës 1 (një) vit në punët relevante, Raport mjekësor se posedon aftësi të mira shëndetësore për pozitën që konkurron , Vërtetimin e Gjykatës që nuk është i/e dënuar (më e re se gjatë muaj), preferohet të posedoj patentë shoferin me "B" kategori dhe Letër Njoftimi.

Detyrat e punëve : për këtë pozitë mund t'i gjeni në Web faqen e kompanisë: cabrati.com

Paga : Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

Afati i paraqitjes së kërkesave për këtë pozitë është 15 /pesëmbëdhjetë/ ditë nga dita e publikimit, (nga data 14.06.2022 e deri me datë 28.06.2022 ora 16:00).

Kërkesën me dokumentacionet e kërkuara, kandidatet duhet t'i dorëzojnë në drejtorin e KRM."Çabrati" SH.A. në Gjakovë, Rr."Mazllom Lakuci" pn. (tek zyra e Menaxherit të Burimeve Njerëzore). Dokumentet pa afat dhe të pakompletuara nuk do të merren për bazë.

Pas kalimit të afatit të konkursit, kandidatet i nënshtrohen procedurës së testit dhe intervistës.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Sada Ninaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I – VIII- SHFMU "Ibrahim Fehmiu" Prizren.

► Nazife Ademi shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Jusuf Rexha" .

► Flurim Kasolli shpall te pavlefshme dëftesat e kp I – VIII- SHFMU "Vëllezërit Frashëri" Planaj.

► Visar Rexha shpalle te pavlefshme dëftesën e klasës 9-te te shkollës "Azem Bejta".

► Endrit Kolgeci shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI – IX- SHFMU "Leke Dukagjini" Prizren.

► Nuhi Haxha shpalle te pavlefshme diplomën e 'SHMLT "Arkitekt Sinani".

► Xhevdet Shabani shpalle te pavlefshme licencën e punës KO-03170-01-21 e lëshuar nga ministria e shëndetësisë.

► Mevlem Preteni shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës "Trepça".

► Elhame Sylja shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Bedri Gjina" VI-IX .

► Basteri Zenullahi B.I shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit: NRB-810001610.

Veton Dedija shpalle te pavlefshme dëftesat e klasës 10/11 'SHMLT "Arkitekt Sinani" .

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Selvete Bislimi shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës 'SHFMU "Shaban Idrizi".

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Pemba Hajra shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës "Andon Zako Cajupi".

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Daut Mustafa shpalle te pavlefshme dëftesën e klasës 10-të 'SHMLT "Arkitekt Sinani".

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Luljeta Osmani shpalle te pavlefshme dëftesën e klasës 1-8 te shkollës "Fazli Grajqevci" Shipol.

► Remzi Osmani shpalle te pavlefshme dëftesat diplomën 'SHMLT "Arkitekt Sinani".



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Në bazë të nenit 21 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odar e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenin 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Oda e Mjekëve të Kosovës shpall këtë:

KONKURS

NËPUNËS I JASHTËM PËR TEKNOLOGJI INFORMATIVE

Numri i pozitave: 1 (një vend pune),

Nr. ref: 03/2022

Kohëzgjatja e Kontratës: 60 (gjashtëdhjetë) ditë pune për 1 (një) vitë kalendarik me mundësi vazhdimi edhe për një vit të tjetër.

Lloji i kontratës: Kontratë për punë dhe detyra specifike

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Propozon, zhvillon dhe mbështet implementimin e politikave/strategjive për zhvillimin e sistemit të informimit të OMK-së;
- Menaxhon procesin e zhvillimit të Sistemit të Informimit të OMK-së duke përfshirë procesin e prokurimit të komponenteve softuerike dhe infrastrukturës harduerike;
- Koordinon procesin e implementimit të Sistemit të Informimit të OMK-së;
- Raporton tek Kryetari i OMK-së për përmbushjen e aktiviteteve nga plani vjetor i veprimit, sfidat dhe problemet e paraqitura si dhe masat korrektuese që duhen të ndërmerren;
- Punon me OMK-në për projektet e Teknologjisë Informative;
- Planifikon afatet dhe resurset që nevojiten lidhur me projektet e TI-së;
- Qartëson dhe përpilon specifikat e sistemeve të OMK-së;
- Përcakton kërkesat softuerike, harduerike dhe ato të rrjetit të internetit të OMK-së;
- Analizon kërkesat e TI-së brenda OMK-së dhe jep këshilla objektive të pavarura në përdorimin e TI-së;
- Prezanton zgjidhje me raport të shkruar dhe verbal;
- Teston, instalon dhe monitoron sistemet e reja;
- Përgatit dokumentimin dhe prezanton raportet e progresit për OMK-në;
- Organizon trajnime lidhur me TI-në për përdoruesit dhe konsulentët e tjerë;
- Gjen zgjidhje për nevojat imediate të OMK-së në kuptim të automatizimeve të proceseve, migrimit të të dhënave dhe zhvillimit të veglave minore softuerike;
- Asiston stafin e OMK-së në mirëmbajtjen e web-faqes zyrtare të OMK-së;
- Koordinon bashkëpunimin me kontraktorët e jashtëm për shërbime të IT-së;

Shkollimi i kërkuar:

- Diplomë universiteti në fushën e teknologjisë së informacionit apo në drejtë të ngjashme;
- Të paktën 5 vjet përvojë pune në fushën e TI-së;
- Të paktën 3 vjet përvojë mbikëqyrëse të projekteve të TI-së;
- Aftësi për të përpiluar dokumente dhe raporte teknike;
- Aftësi të shkëlqyeshme komunikimi dhe ndërpersonale;
- Aftësi për të shpjeguar çështje komplekse teknike në mënyrë të thjeshtë dhe të qartë;
- Njohja e gjuhës angleze;

Detyrat specifike

- Asiston në mbarëvajtjen e punëve me stafin e OMK-së për analizimin e proceseve të punës dhe përpilimit të BPM (business process mapping);
- Asiston në finalizimin dhe testimin e zgjidhjes së përkohshme softuerike për nevojat e OMK-së;

Paraqitja e kërkesave:

Inkurajohen të aplikojnë të gjithë kandidatët e interesuar të cilët i plotësojnë kushtet e lartëcekura. Formularët për aplikim mund të shkarkohen nga ueb faqja e OMK-së, www.omk-rks.org dhe të gjitha aplikacionet e plotësuara së bashku me kopjen e letërnjoftimit, kopjet e dëshmitave për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kursat e ndjekura, referencat si dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit, mund të dorëzohen:

- Përmes e-mail adresës info@omk-rks.org

Në subjekt të emailit të ceket pozita për të cilën aplikoni dhe emri, mbiemri juaj!

Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit dhe do të jetë i hapur nga data: **13.06.2022** deri më **28.06.2022**.

Për informata shtesë mund të kontaktoni në numrat e telefonit: **049/872 300** apo **038 / 544 872**.

Konkursi dhe aplikacioni për punësim janë të publikuara edhe në Ueb-Faqen e Odës: <https://omk-rks.org/>



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – Lekarska Komora Kosova

FTESË PËR OFERTË

Lloji i Kontratës: Furnizim Shërbime Punë

Nr. i Prokurimit 08-22

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbron veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në adresën **Instituti A, Kati 2, QKUK, 10000 Prishtinë**, apo përmes emailit: **info@omk-rks.org**, me titullin:

Dosja për: Kontratë për furnizim me material shpenzues për zyret e OMK-së

Në pajtim me Nenin 8, paragrafin 1 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €).

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të mesme (vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €).

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uebin e Odës: <https://omk-rks.org/>

Afatet Kohore.

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: **24.06.2022 ora 14:00**.

Afati i fundit për aplikim në Tender është: **27.06.2022 ora 12:00**.

Hapja e ofertave bëhet me datën: **27.06.2022 ora 14:00**.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – Lekarska Komora Kosova

FTESË PËR OFERTË

Lloji i Kontratës: Furnizim Shërbime Punë

Nr. i Prokurimit 09-22

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbron veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në adresën **Instituti A, Kati 2, QKUK, 10 000 Prishtinë**, apo përmes emailit: **info@omk-rks.org**, me titullin:

Dosja për: Kontratë për furnizim me inventar për nevojat e zyrës të OMK-së

Në pajtim me Nenin 8, paragrafin 1 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €).

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të mesme (vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €).

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uebin e Odës: <https://omk-rks.org/>

Afatet Kohore.

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: **17.06.2022 ora 14:00**.

Afati i fundit për aplikim në Tender është: **20.06.2022 ora 12:00**.

Hapja e ofertave bëhet me datën: **20.06.2022 ora 14:00**.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L